



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIKËQYRJES DHE ANKESAVE
ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2022

Lënda: Kthim përgjigje

ZNJ. ALMIRA KADËNA

Në përgjigje të kërkesës suaj datë 22.06.2022, protokolluar me tonën nr. 4551, datë 26.07.2022, me anën e së cilës kërkon informacion publik dhe kopje dokumentacioni lidhur me procesin e dekriminalizimit, për vitin 2016, Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju informon si më poshtë vijin:

Bazuar në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””, DAP është organi përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në legjislacionin e sa më lartë cituar, nga viti 2016 e në vijim, DAP ka vijuar me realizimin e procesit të verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjektet në formular, publikimin në faqen zyrtare të tij të internetit apo në portalin qeveritar e-albania të formularëve, azhornimin e listës së funksionarëve publikë që kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit, azhornimin e rezultateve të verifikimit të funksionarëve publikë të konstatuar në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik, sipas ligjit nr.138/2015, i ndryshuar, etj.

Rezulton se, DAP për vitin 2016 ka administruar rreth 24.000 formularë vetëdeklarimi, të dorëzuar nga subjektet vetëdeklarues, nga të cilët:

- 78 subjekte u konstatuan në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik sipas ligjit nr.138/2015, i ndryshuar, në përfundim të procedurave të parashikuara në kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- 97 funksionarë publik në detyrë, nuk depozituan formularin e vetëdeklarimit, brenda afateve ligjore të përcaktuar nga legjislacioni, për të cilët u vijua me marrjen e masave administrative, të përcaktuara në dispozitat ligjore përkatëse.

Në zbatim të detyrimeve, të përcaktuara nga legjislacioni i sa më lartë cituar, në faqen zyrtare të DAP do të gjeni të publikuar:

- Listën e subjekteve vetëdeklarues që kanë depozituar formular vetëdeklarimi, pranë organit përgjegjës DAP, nga viti 2016 e në vijim, në linkun <https://www.dap.gov.al/publikime/formularet>;
- Listën e subjekteve vetëdeklarues të cilët pas verifikimit, janë konstatuar në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik, sipas ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, në linkun <https://www.dap.gov.al/images/documents/Subjekte%20te%20Konstatuar%20ne%20Kushtet%20e%20Ndalimit%20te%20Ushtrimit%20te%20Funksionit.pdf>;
- Raportet vjetore të DAP, në linkun <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>.

Ndërkohë, sikurse ju bëmë me dije me shkresën nr. 4551/2 prot., datë 01.08.2022, në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, si dhe për të qenë rigoroz me përcaktimet e bëra në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, DAP me shkresën nr. 4551/1 prot., datë 01.08.2022 kërkoi dhënie mendimi nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Zyra e Komisionerit), për informacionin që mund t’ju vihet në dispozicion, konkretisht lidhur me kopjet e shkresave drejtuar institucioneve publike, për marrjen e masave për largim/lirim nga detyra të funksionarëve publik, për shkak të konstatimit të tyre në kushtet e ndalimit sipas ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, apo për shkak të mosdepozitimit nga ana e tyre të formularit brenda afatit ligjor të përcaktuar.

Me shkresën nr. 1395/1 prot., datë 05.08.2022 Zyra e Komisionerit, ndër të tjera, thekson se: *“...Përhapja e të dhënave personale konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e saknksionuara në nenin 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, **“Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin; ...ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit...”***

Në nenin 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përcaktohet se:

“1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat. Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij... 6. Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pike të këtij neni është bërë ky refuzim...”

Në nenin 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Të dhënat personale përpunohen vetëm: a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin; Por, në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private... Asnjë e dhënë personale shtesë nuk mund t’i bashkëlidhet të dhënave të specifikuar më lart, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave. ...”

Neni 63 i ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, përcakton se: “...Ndalohej njohja, shfrytëzimi dhe publikimi i dokumenteve që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe çënojnë jetën private të personit. Dokumentet që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe çënojnë jetën intime të personit, shërbejnë vetëm pasi kanë kaluar, sipas rastit, 50 deri në 150 vjet nga data e krijimit të tyre”.

Në shkronjën “g”, të pikës 2, të nenit 65 parashikohen kufizimet për shfrytëzimin e dokumenteve arkivore, e konkretisht: “Kufizimet mund të zbatohen edhe në funksion: ...g) të interesave të tjerë të individit, që vlerësohen të ligjshëm nga institucionet e specializuara”.

Për më tepër, në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 67, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Leje për shfrytëzimin e parakohshëm të dokumenteve, që kufizohet shërbimi, në nenet 61, 62 dhe 63 të këtij ligji u jepen përkatësisht c) nga vetë personi, për dokumentet që përmbajnë të dhëna intime dhe që kanë të bëjnë me dinjitetin personal të tij”.

Gjithashtu, në kuadër të ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, shtetasit subjekt vetëdeklarimi, me dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit japin pëlqimin për verifikimin e plotë dhe të gjithanshëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme për çdo të dhënë personale të pasqyruar prej tyre në formular. Trajtimi i të dhënave duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në vijim të dhënies së pëlqimit në formular, nga subjektet që mbartin detyrimin për vetëdeklarim, në kuadër të legjislacionit të sa më lartë cituar, organi përgjegjës DAP pas administrimit të të dhënave të pasqyruara nga këto subjekte, ka vijuar me përpunimin,

verifikimin dhe publikimin e tyre në kuadër të këtij ligji, duke përmbushur kështu qëllimin e përpunimit të të dhënave që subjekti ka dhënë pëlqimin.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi i ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, është përmbushur, si dhe disa nga të dhënat e kërkuara nga ana juaj, referuar pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, përbëjnë të dhëna sensitive, që mund të dëmtojnë të drejtën për një jetë private të subjektit vetëdeklarues, ndodhemi në kushtet e kufizimit të vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Referuar shkresës nr. 1395/1 prot., datë 05.08.2022 të Zyrës së Komisionerit, DAP vlerëson dhënien ose kufizimin e dhënies së informacionit të kërkuar nga ana juaj, lidhur me vënien në dispozicion të kopjeve të shkresave drejtuar institucioneve përkatëse, për marrjen e masave për largim/lirim nga detyra të funksionarëve publik, për shkak të konstatimit të tyre në kushtet e ndalimit sipas ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar, si dhe për shkak se nuk kanë dorëzuar formular vetëdeklarimi brenda afatit ligjor të përcaktuar.

Faleminderit për mirëkuptimin.